



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.2021

V E N D I M

Nr. 495, datë 25.10.2021

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. REZARTA ALIU
DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË EMËRIMIT NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE
TË APELIT TIRANË, PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS
ADMINISTRATIVE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 290, DATË 06.07.2021 TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.10.2021, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, të kandidatës, znj. Rezarta Aliu”, për gatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatës znj. Rezarta Aliu dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“I. Hapja e procedurës dhe shpallja e kërkesës për kandidatura

- 1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.*
- 2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë.*

II. Afati i kandidimit 3. Afati i kandidimit është deri më datë 21.07.2021 ...”

2. Vendimi si më lart, krahas edhe një njoftimi për rihapjen e kësaj procedure ngritjeje në detyrë, janë publikuar rregullisht në faqen zyrtare të internetit të Këshillit më datë 07.07.2021, duke filluar të ecë afati i kandidimit nga dita e nesërme.

3. Brenda afatit të kandidimit, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin si më sipër të Këshillit, ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. Rezarta Aliu (më poshtë referuar si kandidatja), e cila ka caktimin e përhershëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, ndërsa aktualisht është transferuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

4. Ndërkohë, më herët, znj. Rezarta Aliu ka kandiduar për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, fillimisht për tre pozicione të lira, por më pas, në rastin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, në respektim të kufizimit të kandidimeve sipas pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), është tërhequr nga kandidimi për një nga pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm¹, shkak për të cilin Këshilli ka vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për kandidaten znj. Aliu². Kandidatja vijon konkurrimin për dy nga pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm (në Gjykatën e Apelit Tiranë³), procedura ngritjeje në detyrë këto që vijnë të jenë në proces.

5. Në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit edhe për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin sipas pikës 1, të këtij relacioni, Këshilli, me Vendimin nr. 334, datë 28.07.2021, ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.....”

6. *Për kandidaten znj. Rezarta Aliu (Paja), e cila ka kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që ka përfunduar për këto kandidime, është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.*

¹ Për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin nr. 396 datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

² Me Vendimin nr. 350, datë 09.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

³ Për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me Vendimin nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

6. Në kuadër të procedurës së verifikimit të kandidatës znj. Rezarta Aliu, më datë 28.07.2021, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimit 75/2019), në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

7. Brenda afatit të përcaktuar, kandidatja nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

8. Në vendimin për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë ku ka kandiduar edhe znj. Aliu, pra në Vendimin e Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021, është përcaktuar se: “...5. Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen në pikën 3, të nenit 8, në pikën 4, të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës administrative, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”; c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar....”.

9. Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. Rezarta Aliu, siç do të përshkruhet më poshtë.

9.1 Për verifikimin e kritereve të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht nënkriterit të “përvojës specifike profesionale” të kandidatës në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës administrative, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarës, konkretisht në Gjykatën e Rrethit

Gjyqësor Tiranë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet informacioni nuk iu rikërkuar gjykatave, pasi referuar të dhënave, kandidatja znj. Rezarta Aliu, ka gjykuar *çështje të karakterit civil, penal dhe administrativ*. (Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 7307/1 prot., datë 10.11.2020. Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 675 prot. datë 17.11.2020)⁴

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, informacioni nuk u kërkuar, ndërsa është e qartë përvoja e kandidatës në fushën e të drejtës administrative (pra pas datës 13.06.2018 e në vijim)⁵.

10. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidaten Rezarta Aliu, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 14.10.2021, relatorja e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 14.10.2021 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin e kandidatës Rezarta Aliu dhe vijimin e procedurës së mëtejshme të emërimit në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 290, datë 06.07.2021 ose skualifikimin e kandidatës dhe përjashtimin e saj nga procedura e emërimit në këtë pozicion në Gjykatën Administrative të Apelit.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT

12. Për kandidaten znj. Rezarta Aliu u verifikua kriteri i “*përvojës profesionale minimale*”.

13. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën Administrative të Apelit, që gjën reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*.

⁴ Vendimi nr. 626 datë 10.12.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për verifikimin paraprak të tre kriterëve të kandidimit të kandidatës znj. Rezarta Aliu”

⁵ Vendimi nr. 47 datë 13.06.2018 i ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë
Vendimi nr. 98 datë 21.06.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor
Vendimi nr. 203 datë 11.06.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor
Vendimi nr. 260 datë 17.06.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor

14. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit u mbajt parasysh se në këtë gjykatë gjykohen çështje me lëndë administrative, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës administrative për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021.

15. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesën për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2009. Kandidatja ka kryer stazhin profesional si gjyqtare në kuadër të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës në vitet 2009-2010 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas me vendimin nr. 47 datë 13.06.2018 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë është transferuar për një vit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Me vendimet nr. 98 datë 21.06.2019, nr. 203 datë 11.06.2020 dhe nr. 260 datë 17.06.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i është përsëritur transferimi për në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ku vijon dhe aktualisht.

16. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. Rezarta Aliu, fillimin në detyrë e ka me dekretin nr. 5992 datë 07.01.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë ku është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas me dekretin nr. 6629 datë 25.06.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, është emëruar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet. Me vendimin nr. 47 datë 13.06.2018 të ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë është transferuar për një vit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Me vendimet nr. 98 datë 21.06.2019, nr. 203 datë 11.06.2020 dhe nr. 260 datë 07.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i është përsëritur transferimi për në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ku vijon dhe aktualisht.

17. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. Rezarta Aliu, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

18. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka eksperiencë të mjaftueshme në fushën e të drejtës administrative prej më shumë se 5 vjetësh.

19. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se:

“... znj. Rezarta Aliu, fillimin në detyrë e ka me Dekretin nr. 5992, datë 07.01.2009, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë kësaj gjykate.

Në lidhje me sa kërkoni, për periudhën kohore për të cilën kërkohet informacioni për përvojën e gjyqtares znj. Rezarta Aliu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk disponon urdhra të Kryetarit për ndarjen në dhoma/seksione të gjyqtarëve.

Në mungesë të tyre, bashkëngjitur kësaj shkrese, gjeni në format statistikor, llojet e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtare znj. Rezarta Aliu, për periudhën 07.01.2009 – 25.06.2010...”.

19.1. Referuar të dhënave të regjistrit të vendimeve për vitin 2009 - 2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kandidatja znj. Rezarta Aliu, referuar objektit të çështjeve gjyqësore, është shortuar dhe ka gjykuar çështje të karakterit civil, penal dhe administrativ.

20. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton se:

“...Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, ku ka ushtruar funksionin e gjyqtarit znj. Rezarta Aliu, pas emërimit të saj me dekretin nr. 6629, datë 25.6.2010 të Presidentit të Republikës, ka funksionuar me organikë të përbërë nga katër gjyqtarë (shih dekretet nr. nr. 6265, datë 16.09.2009 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë dhe të apelit” dhe nr. 7818, datë 16.11.2012 “Për caktimin e numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë të shkallës së parë, të apelit dhe të gjykatave administrative, si dhe caktimin e kompetencave tokësore dhe selisë qendrore të gjykatave administrative” të Presidentit të Republikës).

Për shkak të kësaj organike, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, nuk ka qenë e organizuar në seksione apo dhoma dhe gjyqtarët, kanë gjykuar të gjitha llojet e çështjeve që janë paraqitur përpara gjykatës.

Gjyqtarja znj. Rezarta Aliu ka gjykuar çështje civile, penale, familjare, si dhe çështje administrative, përpara hyrjes në fuqi të ligjit 49/2012, datë 3.5.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar...”.

20.1 Referuar të dhënave të mësipërme për vitin 2010 - 2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, kandidatja znj. Rezarta Aliu, ka gjykuar çështje të karakterit civil, penal dhe administrativ.

21. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, është e qartë përvoja e kandidates në fushën e të drejtës administrative, prej datës 13.06.2018 ku dhe vijon aktulaisht⁶.

⁶ Vendimi nr. 47 datë 13.06.2018 i ish Këshillit të Lartë të Drejtësisë
Vendimi nr. 98 datë 21.06.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor

22. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. Rezarta Aliu, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës administrative.

23. Për kandidaten znj. Rezarta Aliu u verifikua edhe kriteri i “*mospasjes masë disiplinore në fuqi*”.

24. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë*”.

25. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 16.07.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: “*Nuk kam masë disiplinore në fuqi*”.

26. Sipas informacionit të përcjellë në rrugë elektronike me datë 23.09.2021 nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. Rezarta Aliu nuk ka masa disiplinore në fuqi.

27. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. Rezarta Aliu të ketë masë disiplinore në fuqi.

28. Për kandidaten znj. Rezarta Aliu u verifikua edhe kriteri i “*papajtueshmërisë ambientale*”.

29. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë*”. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës:

Vendimi nr. 203 datë 11.06.2020 i Këshillit të Lartë Gjyqësor
Vendimi nr. 260 datë 17.06.2021 i Këshillit të Lartë Gjyqësor

“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: “Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.

30. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 16.07.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

31. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. Rezarta Aliu nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

32. Ndërkohë, lidhur me kriteret e pasurisë dhe të figurës, në kuadër të procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021, duke qenë se znj. Aliu kishte kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, si dhe duke patur në konsideratë se këto kriteret janë të njëjta për çdo kandidim ngritjeje në detyrë, në pikën 6, të Vendimit të Këshillit nr. 334, datë 28.07.2021⁷, u përcaktua se procedura e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që ka përfunduar për këto kandidime, është e vlefshme edhe për kandidimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

33. Procedura e verifikimit të kriterëve të pasurisë dhe figurës për kandidaten znj. Aliu, në kuadër të kandidimeve të saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, ka përfunduar me Vendimin nr. 268, datë 28.06.2021, me të cilin Këshilli ka vendosur:

“1. Kualifikimin e kandidates znj. Rezarta Aliu dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, (në fushën e të drejtës civile), për dy pozicionet e lira, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020 dhe (në fushën e të drejtës penale), për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 396, datë 07.10.2020...”.

⁷ Vendimi për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit.

34. Procedura e verifikimit të kriterëve ligjorë të kandidimit e realizuar në kuadër të kandidimit të znj. Aliu për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 394 dhe nr. 395, datë 07.10.2020, është përcaktuar nga Këshilli⁸ si e vlefshme edhe sa i përket kandidimit të saj për ngritjen në detyrë në këtë gjykatë, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 290, datë 06.07.2021.

III. KONKLUZIONE

35. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit për kandidaten Rezarta Aliu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

36. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit për kandidaten Rezarta Aliu, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290 datë 06.07.2021.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 4, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidates znj. Rezarta Aliu dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën Administrative të Apelit për pozicionin e lirë, të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 290, datë 06.07.2021.
2. Vendimi nr. 268, datë 28.06.2021, i Këshillit të Lartë Gjyqësor është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

⁸ Me Vendimin nr. 334, datë 28.07.2021.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. Rezarta Aliu sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR